

Në bazë të dispozitave të statutit të ESLG-së (European School of Law and Governance), Bordi i ESLG-së nxjerr si në vijim:

RREGULLOREN PËR BURSA DHE NDIHMË FINANCIARE

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret për dhënien e bursave meritore apo zbritjeve financiare të bazuara në gjendjen financiare të studentit për të gjitha programet e akredituara të ESLG-së

Neni 2

Numri i bursave në dispozicion do të caktohet çdo vit akademik veçmas me vendim të Bordit të ESLG-së

Neni 3

Madhësia e bursës meritore varet nga nota mesatare e studentit gjatë shkollimit paraprak

Neni 4

Edhe studentëve ekzistues të ESLG-së të cilët arrijnë notë të lartë gjatë studimeve në vitin përkatës akademik i takon një përqindje e caktuar e notës mesatare e cila varet nga nota mesatare e arritur gjatë vitit akademik.

Neni 5

Studentët të cilët janë të punësuar të ESLG-së i takon bursë 100 %

Neni 6

Të gjithë përfituesit e bursës meritore duhet të mbajnë bursën duke arritur një notë minimale mesatare gjatë vitit akademik. Në rast se kjo notë nuk arrihet Bordi rezervon të drejtën që të revokojë bursën.

Neni 7

Bursa meritore vlen për tërë vitet akademike të studimeve megjithatë shqyrtohet në fillim të vitit vijues akademik dhe është objekt i notës së arritur mesatare.

Neni 8

Studentët kanë të drejtë gjithashtu në zbritje financiare e cila varet nga kushtet financiare të studentit.

Neni 9

Zbritja financiare vlen për të trija vitet dhe nuk është objekt I notës mesatare por i kushteve financiare të kandidatit.

Neni 10

Përfituesi i ndihmës financiare në fillim të çdo viti akademik duhet të dëshmojë gjendjen e tij financiare e cila dëshmohet me pagën bruto personale, të ardhurat mujore familjare (nëse studentit nuk është i punësuar).

Neni 11

Dëshmitë e ofruara për aplikantët për zbritje financiare janë: 1) kontrata e punës së studentit ose prindit ose prindërve; 2) vërtetimi mbi kontributet pensionale dhe tatimin në burim të paguar në Administratën Tatimore të Kosovës.

Neni 12

Përfitues të zbritjes financiare janë edhe kategoritë e dala nga lufta, fëmijët e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve të luftës.

Neni 13

Përzgjedhja e kandidatëve nga kategoria e parashikuar në nenin 12 do të bëhet në konsultim të ngushtë me Shoqatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së.

Neni 14

Si bursa meritore gjithashtu edhe zbritja financiare e bazuar në kushtet financiare aplikohet në formë të zbritjes së drejtpërdrejtë në pagesën normale të shkollimit.

II. Kriteret për përqindjen e bursave meritore

Neni 15

Kriteret për përfitimin e bursës meritore në studimet bachelor janë paraqitur si mëposhtë:

- 1) Bursa 100 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare 5.0 dhe rezultatin në testin e maturës më të lartë se 185 poena apo merr më shumë se 92.5 % në Testin për Bursë të organizuar në Kolegjin ESLG;

- 2) Bursë 90 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare 5.0 dhe rezultatin në testin e maturës më të lartë se 180 poena apo merr më shumë se 90.0 % në Testin për Bursë të organizuar në Kolegjin ESLG;
- 3) Bursë 80 % - Studenti duhet të jetë notën mesatare 5.0 dhe rezultatin në testin e maturës ndërmjet 170 - 179 poena apo merr poena ndërmjet se 85.0 % dhe 89.5 % në Testin për Bursë të organizuar në Kolegjin ESLG;
- 4) Bursë 70 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare më së paku 5.0 dhe rezultatin në testin e maturës ndërmjet 160-169 apo merr poena ndërmjet se 80.0 % dhe 84.5 % në Testin për Bursë të organizuar në Kolegjin ESLG;
- 5) Bursë 60 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare më së paku 4.5 dhe rezultatin në testin e maturës më të lartë se 150 apo merr më shumë se 75.0 % në Testin për Bursë të organizuar në Kolegjin ESLG;
- 6) Bursë 50 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare më së paku 4.0 dhe rezultatin në testin e maturës më të lartë se 130 apo merr më shumë se 72.5 % në Testin për Bursë të organizuar në Kolegjin ESLG ;
- 7) Bursë 40 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare më së paku 4.0 dhe rezultatin në testin e maturës prej 120 – 129 apo merr më shumë se 70.0 % në Testin për Bursë të organizuar në Kolegjin ESLG;
- 8) Bursë 30 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare më së paku 4.0 dhe rezultatin në testin e maturës prej 110 – 119;
- 9) Bursë 20 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare më së paku 4.0 dhe rezultatin në testin e maturës prej 100 – 109;

Neni 16

Kriteret për përfitimin e bursës meritore në studimet master janë paraqitur si mëposhtë:

- 1) Bursë 100 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare së paku 9.75;
- 2) Bursë 90 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare ndërmjet 9.5 dhe 9.75;
- 3) Bursë 80 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare ndërmjet 9.3 dhe 9.5;
- 4) Bursë 70 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare ndërmjet 9.0 dhe 9.3;
- 5) Bursë 60 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare ndërmjet 8.7 dhe 9.0;
- 6) Bursë 50 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare ndërmjet 8.5 dhe 8.7;
- 7) Bursë 40 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare ndërmjet 8.3 dhe 8.5;
- 8) Bursë 30 % - Studenti duhet të ketë notën mesatare ndërmjet 8.0 dhe 8.3;

Neni 17

Studentët të cilët janë të punësuar në institucione publike apo sektorin privat në ato kompani në të cilat ata kanë fituar kompetenca dhe shkathësi të cilat ndërlidhen me kompetencat e përgjithshme dhe specifike të programeve të akredituara të ESLG-së janë përfitues të bursës prej 50 %.

Neni 18

Studentët ekzistues të ESLG-së të cilët arrijnë notë mesatare prej 9.0 deri 9.5 gjatë vitit përkatës akademik fitojnë zbritje shtesë prej 50 % nga pagesa e shkollimit e parashikuar me kontratë.

Neni 19

Studentët ekzistues të ESLG-së të cilët arrijnë notë mesatare prej 9.5 deri 9.75 gjatë vitit përkatës akademik fitojnë zbritje shtesë prej 70 % nga pagesa e shkollimit e parashikuar me kontratë.

Neni 20

Studentët ekzistues të ESLG-së të cilët arrijnë notë mesatare prej 10.0 gjatë vitit përkatës akademik fitojnë zbritje shtesë prej 100 % nga pagesa e shkollimit e parashikuar me kontratë.

III. Kriteret për përqindjen e zbritjeve financiare të bazuar në kushtet financiare

Neni 21

Studentët të cilët kanë të ardhura mesatare familjare mujore më të vogla se 300 EUR bruto fitojnë zbritje financiare prej 70 % nga pagesa e shkollimit e programit përkatës të studimeve.

Neni 22

Studentët të cilët kanë të ardhura mesatare familjare mujore prej 400 EUR bruto fitojnë zbritje financiare prej 60 % nga pagesa e shkollimit e programit përkatës të studimeve.

Neni 23

Studentët të cilët kanë të ardhura mesatare familjare mujore prej 500 EUR bruto nga pagesa e shkollimit e programit përkatës të studimeve fitojnë zbritje financiare prej 50 % nga pagesa e shkollimit e programit përkatës të studimeve.

IV. Dispozitat përfundimtare

Neni 24

Numri i bursave dhe zbritjeve financiare caktohet çdo vit akademik nga Bordi i ESLG-së.

Neni 25

Bursat meritore, zbritjet financiare dhe bursat e kategorive të dala nga lufta vlejnë vetëm për programet studimore të akredituara nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës të cilat rezultojnë në diplomë kosovare.

Neni 26

Bursat meritore, zbritjet financiare dhe bursat e kategorive të dala nga lufta nuk vlejné për programet studimore franchise të akredituara nga agjencitë e huaja të akreditimit të cilat rezultojné në diploma të huaja apo diploma të dyfishta.

Neni 27

Kryetari i Bordit Menaxhues i ESLG-së do të jetë përgjegjës për përzgjedhjen e kandidatëve për bursa meritore dhe zbritje financiare dhe do të jetë përgjegjës për implementimin e këtyre bursave dhe rishikimin e tyre çdo vit akademik.

Neni 28

Ky rishikim do të bëhet çdo vit akademik deri më 20 tetor të vitit përkatës.

Neni 29


Për studentët të cilët janë të punësuar në të njëjtën kohë në ESLG shkollimi falas vlen përderisa ata janë të punësuar në ESLG. Në momentin e shkëputjes së kontratës me ESLG studentët në fjale duhet të paguajnë pagesën normale të shkollimit.

Neni 30


Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga ana e anëtarëve të Bordit Menaxhues

Prishtinë dhe Nova Gorica me 10.10.2010

MIHA POGAČNIK, KRYETAR I BORDIT MENAXHUES



PETER JAMBREK, ANËTAR I BORDIT MENAXHUES



VISAR HOXHA, ANËTAR I BORDIT MENAXHUES

